



ProCredit Bank

Pyetjet e shpeshta (FAQ) –
TOP Credit Card



1. Çfarë është kredit kartela TOP?

TOP është kartela e kreditit me këste nga ProCredit Bank që ju jep lirinë të menaxhoni shpenzimet ashtu si ju përshtatet. Me një limit kreditor të miratuar nga banka, mund të kryeni blerje të menjëhershme ose t'i ndani ato në këste. Për blerjet me këste, TOP ofron mundësinë e pagesës pa interes për periudha të caktuara, deri në 36 muaj. *

(Referoju çmimores për detaje rreth kushteve dhe normave përkatëse)

2. Cilat janë veçoritë kryesore të kred kartelën TOP?

- **0% interes** në të gjitha blerjet me këste*
- **Ndarja e pagesave deri në 36 këste** në rrjetin e ProCredit Bank (POS & online)
- **Ndarja e pagesave deri në 12 këste** përmes Mobile App*
- **Tërheqje cash** deri 50% të limitit të kartelës
- **Pagesë mujore fleksibile:** minimale 15% ose të plotë (100%)
- **Cikli i faturimit:** nga data 1 deri me datën 15
- **15 ditë pa interes ose penalti**, nëse shlyhet borxhi brenda periudhës së caktuar (para datës 16 të muajit)

**(Referoju çmimores për detaje rreth kushteve dhe normave përkatëse)*

3. Kush mund të aplikojë për kartelën TOP?

- Personat mbi moshën 18 vjeçare
- Klientët e ProCredit Bank
- Klientët e bankave tjera
- Mund të aplikohet edhe për TOP me cash cover (limit i siguruar me depozitë).

4. Si mund të aplikoj për kartelën TOP?

Për të aplikuar për **TOP Card**, ju duhet të jeni klient i **ProCredit Bank** dhe të keni një **llogari rrjedhëse aktive**.

Aplikimi mund të bëhet:

- **Përmes Mobile App**, pasi të keni hapur llogarinë tuaj
- Përmes ueb-faqes zyrtare
- **Në degët e ProCredit Bank**



5. Si funksionon ndarja në këste e pagesave nga Mobile App?

Përmes aplikacionit mobil, ju mund t'i ndani në këste blerjet ose tërheqjet në para. Kjo mund të bëhet edhe duke vizituar degën.

Ndarja në këste është e mundur për:

- **Blerjet në POS jashtë vendit** – transaksione me kartelë në POS jashtë vendit.
- **Blerjet online jashtë vendit** – pagesa në tregtarë ndërkombëtarë (e-commerce).
- **Tërheqjet cash** – në ATM të ProCredit Bank dhe ATM të bankave të tjera, brenda ose jashtë vendit.

(Referoju çmimore për detaje rreth kushteve dhe normave përkatëse.)

6. Si funksionon ndarja në këste e pagesave në rrjetin e ProCredit Bank?

Ju mund të përfitoni nga pagesa me këste me **0%** interes direkt gjatë blerjes, në:

- POS терминаlet e ProCredit Bank në pikat tona bashkëpunëtoare
- Dyqanet online (e-Commerce) që pranojnë pagesa me ProCredit Bank

Numri i kësteve mund të jetë deri në 36 muaj, varësisht nga marrëveshja me tregtarin.

7. A mund të përdoret TOP kartela jashtë vendit?

Po. TOP kartela mund të përdoret për **transaksione ndërkombëtare** dhe **blerje online** në çdo tregtar që pranon kartelat **Mastercard**.

Për blerjet e kryera jashtë vendit, ju mund t'i ndani pagesat deri në **12 këste**, përmes **Mobile App** ose duke vizituar një nga degët e ProCredit.

(Referoju çmimore për detaje rreth kushteve dhe normave përkatëse.)

8. Si funksionon pagesa mujore?

Çdo muaj, ju mund të zgjidhni të paguani **15%** të shumës së përdorur ose të shlyeni shumën e plotë deri më datën 15 të muajit vijues.

Nëse në ditën e faturimit nuk keni mjete të mjaftueshme në llogari, sistemi do të provojë çdo ditë të kryejë pagesën. Gjatë kësaj periudhe, deri më datën 15, nuk aplikohet interes apo penalti, pavarësisht numrit të tentimeve. Prej datës 16, fillon të kalkulohet penalti ose interes deri në momentin e shlyerjes së borxhit.

(Referoju çmimore për detaje rreth kushteve dhe normave përkatëse.)



Menaxhimi i Kartelës së Kreditit përmes Aplikacionit Mobil të ProCredit

1. Si mund ta shoh limitin e kartelës?

Përmes aplikacionit mund të kontrolloni: limitin total të kartelës, limitin e disponueshëm shumë e përdorur, pagesën minimale, vlerën e bonusit dhe këstin e ardhshëm.

2. Si mund të shoh historikun e transaksioneve?

Të gjitha blerjet, ripagesat dhe tërheqjet e kartelës shfaqen në listën e transaksioneve brenda Mobile App, tek moduli i kartelave > kredit kartela.

3. Si mund të menaxhoj limitin e kartelës?

Ju mund të kërkon **rritje të limitit** të kartelës drejtpërdrejt përmes **Mobile App**, brenda kufijve të përcaktuar nga banka.

Në **degët e ProCredit Bank**, mund të kërkon ndryshimin e limitit të kartelës tuaj.

4. Si mund të ndryshoj PIN-in e kartelës?

Ndryshimi i PIN-it bëhet direkt në Mobile App përmes opsionit “Ndrysho PIN”.

5. A mund ta përdor kartelën në kuletën dixhitale?

Po, mund ta shtoni kartelën në kuletën dixhitale dhe ta përdorni për pagesa “contactless”.

6. Si mund ta bllokoj kartelën në rast humbjeje ose vjedhjeje?

Përdorni opsionin “Blloko kartelën” në **Mobile App** për të parandaluar përdorime të paautorizuara.

7. Si mund të kontrolloj pagesat dhe këstet?

Në seksionin “Këstet” mund të shikoni këstet aktive dhe të arkivuara.

8. Si mund të monitoroj bonuset e kartelës?

Të gjitha bonuset dhe shpërblimet e përfituara nga përdorimi i kartelës janë të aksesueshme në seksionin “Bonuset”.

Ju duhet ndihmë?

Për çdo pyetje shtesë, mund të kontaktoni ekipin tonë në **+383 555 555 / 049 555 555** ose të na shkruani në **kos.kujdesiperkliente@procreditbank-group.com**.